

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, zhvillon takimin përshëndetës me studentët aktuarë

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për muajin janar 2017
- Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 31.12.2016
- Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për vitin 2016

Zhvillime të tjera

- Zhvillohet Forumi i 6-të Botëror mbi Pensionet dhe Investimet
- Zhvillohet Seminari Ndërkombëtar për Mbikëqyrjen e Pensioneve si dhe Mbledhjet e Komitetit Teknik dhe Komitetit Ekzekutiv të IOPS-it
- AMF organizon takim informues me median me fokus tregun e sigurimeve në vend
- Zhvillohet Forumi Ndërkombëtar mbi Sigurimet dhe Konferenca Evropiane për Mbrojtjen Konsumatore
- Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së takohet me përfaqësues të Bankës Qendrore Evropiane
- AMF fillon fazën e dytë të projektit për zhvillimin dhe forcimin e tregut të kapitaleve
- Trajnimi mbi parimet, praktikat dhe bazat e mbikëqyrjes në sigurime me fokus rrezikun, në funksion të rritjes së kapaciteteve profesionale të stafit të AMF- së
- Qendra e Edukimit pranë AMF-së prezanton programin e punës për vitin 2017
- Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare takohet me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar
- IOSCO diskuton mbi teknologjinë financiare në tregun e letrave me vlerë

Edukimi i Konsumatorit

- “Eksplorimi i Horizonteve të Reja” (Pjesa e tretë)

Lajme Ndërkombëtare

- Çeki
- Kosovë
- Mali i Zi
- Turqi

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së zhvillon takimin përshëndetës me studentët aktuarë



Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, Zj. Enkeleda Shehi, gjatë takimit përshëndetës me studentët aktuarë

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi, zhvilloi më datë 21 shkurt 2017, takimin përshëndetës me studentët aktuarë, të cilët janë duke zhvilluar modulën e fundit të programit afatgjatë për kualifikim profesional në sigurime, që pritet të përfundojë në prill 2017.

Të ftuar në këtë takim ishin edhe Z. Neil Hilary, përfaqësues i Institutit dhe Fakultetit të Aktuarëve, Londër, Z. Klaidi Citozi, Drejtor i Përgjithshëm dhe Anëtar Bordi i Shoqërisë së Sigurimit "Sigma Inter-Albanian Vienna Insurance Group" sh.a. si dhe Z. Nexhat Miftari, Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes pranë Bankës Qendrore të Kosovës.

Znj. Shehi në fjalën e saj theksoi rëndësinë e profesionit të aktuarit, si dhe përgëzoi pjesëmarrësit për arritjen deri në këtë fazë të programit duke kaluar me sukses të gjitha provimet pararendëse, duke qenë shumë më pranë certifikimit të tyre si "Aktuar i Autorizuar".

Ky program afatgjatë është i treti ndër vite që AMF organizon në bashkëpunim me Institutin dhe Fakultetin e Aktuarëve në Londër, si dhe Shoqatën Shqiptare të Aktuarëve.

Znj. Shehi vuri theksin në faktin se AMF, si autoritet mbikëqyrës i profesionistëve të licencuar si aktuarë, ka mbështetur gjithnjë rrugën e nisur drejt formimit të profesionit të aktuarit në Shqipëri dhe zhvillimin e mëtejshëm të tij.

Këtë takim e përshëndetën edhe Z. Neil Hilary, Z. Klaidi Citozi dhe Z. Nexhat Miftari duke theksuar edhe njëherë rëndësinë e këtij profesioni parë nga këndvështrimet e ndryshme, si anëtarë të profesionit të aktuarit, drejtues të lartë të tregut të sigurimeve apo edhe nga perspektiva e mbikëqyrësit.

Znj. Shehi falenderoi veçanërisht Z. Neil Hilary dhe të gjithë lektorët e angazhuar në mësimdhënie, të cilët me kontributin e tyre bënë të mundur realizimin me sukses të këtij programi.

Ky program afatgjatë është i treti ndër vite që AMF organizon në bashkëpunim me Institutin dhe Fakultetin e Aktuarëve në Londër, si dhe Shoqatën Shqiptare të Aktuarëve.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë muajit janar 2017 kapën vlerën mbi 1.29 miliardë lekë, ose 26.51% më shumë se në muajin janar 2016. Gjatë muajit janar 2017, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 83,564 me një rritje prej 15.85% krahasuar me muajin janar 2016.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 11.09% në krahasim me muajin janar 2016. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 0.17 miliardë lekë, apo 57.78% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 30.24% gjatë periudhës janar 2017, krahasuar me muajin janar 2016.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohen të kenë arritur vlerën rreth 0.76 miliardë lekë gjatë muajit janar 2017, duke shënuar një rritje prej 24.24% krahasuar me muajin janar të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 58.62% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 12.92% të tregut të Jo-Jetës;

- Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 7.27 % të tregut të Jo-Jetës.

Sigurimi i Jetës


Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 10.85% krahasuar me muajin janar 2016. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit "Jetë debitori" e cila përbën 54.24% të sigurimit të Jetës.

—○○○—
Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 0.76 miliardë lekë gjatë muajit janar 2017.

—○○○—

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar 2017

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



Zhvillimet e Tregut të Fondeve të Investimeve, 31.12.2016

Gjatë vitit 2016, në tregun e fondeve të investimeve ushtruan aktivitetin e tyre tre fonde investimi, përkatësisht Fondi i Investimeve “Raiffeisen Prestigj”, Fondi i Investimeve “Raiffeisen Invest Euro” të cilat administrohen nga shoqëria “Raiffeisen Invest” dhe Fondi i Investimeve “Credins Premium” nën administrimin e Shoqërisë Administruese “Credins Invest”.

Sipas analizës së të dhënave për tregun e fondeve të investimeve në 31.12.2016, vlera neto e asetëve të fondeve, arriti mbi 65.43 miliardë lekë, me një ulje prej 1.56 miliardë lekë ose 2.33%, krahasuar me 31.12.2015.

Ky treg dominohet kryesisht nga investimet në Obligacione Qeveritare, të cilat përbëjnë 64.37% të asetëve të fondeve, me një ulje prej 10.44% krahasuar me 31.12.2015.

Ndërkohë, numri i anëtarëve që kanë investuar në fondet e investimit më 31.12.2016 është 29,267 me një ulje prej 8.96% krahasuar me 31.12.2015. Rreth 99.99% e anëtarëve në fonde janë investitorë individualë.

Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për vitin 2016

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2016 u dominua në masën 82% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe pjesa tjetër prej 18% ishin instrumente afatgjatë (obligacione). Përsa i përket numrit të transaksioneve, 93.76% e të gjitha transaksioneve të

Numri i anëtarëve që kanë investuar në fondet e investimit më 31.12.2016 është 29,267 me një ulje prej 8.96% krahasuar me 31.12.2015.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 99.52% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2016 flasin për një dominim të transaksioneve "Blerje në tregun primar" dhe "Shlyerje e vlerës nominale në maturim" përkatësisht me 56.34% dhe 28.41% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 99.52% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B "Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar" gjatë vitit 2016, ka pasur një ulje prej 1,241 milionë lekë ose 16.01% krahasuar me vitin 2015 dhe numri i transaksioneve është ulur në masën 4.64%.


Transaksioni i llojit C "Blerje para afatit të maturimit" gjatë vitit 2016 ka pasur një rritje prej 818 milionë lekë ose 30.42% krahasuar me vitin 2015 dhe numri i transaksioneve është rritur në masën 37.81%.

Krahasuar me vitin 2015, vihet re një ulje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 423 milionë lekë.

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Lloji i Transaksionit	Periudha	Vlera nominale (në mla. lekë)		Ndryshimi (në %)
		2015	2016	
Letra me Vlerë të Qeverisë				
B	Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	7,752	6,511	(16.01)
	Individë	6,324	5,397	(14.66)
	Persona juridikë	1,428	1,114	(21.98)
C	Blerje para afatit të maturimit	2,689	3,507	30.42
	Individë	2,552	3,025	18.51
	Persona juridikë	136	482	253.30

Letra me Vlerë të Qeverisë, 2016



ZHVILLIME TË TJERA

Zhvillohet Forumi i 6-të Botëror mbi Pensionet dhe Investimet

Në 23-24 shkurt 2017 në Greenwich, Londër, Angli, u zhvillua Forumi i 6-të Botëror mbi Pensionet (*World Pensions Investment Forum*). Forumi u organizua nga Shoqata Ndërkombëtare e Pensioneve dhe e Fondeve të Sigurimeve Shoqërore. Tema kryesore e këtij forumi ishte “Asetet afatgjata të fondeve të pensioneve, pavarësia dhe investitorët në sigurime në kohën e riorganizimit ekonomik dhe ndryshimeve rregullatore”.

Forum i mbledhi drejtues të agjencive rregullatore financiare, hartues të politikave dhe përfaqësues të fondeve private të pensioneve, anëtarë të sindikatave të punonjësve, drejtues nga bankat e zhvillimit, kompanitë e sigurimeve, akademikë, ekspertë nga Banka Botërore dhe Banka Evropiane e Investimeve, etj.

Në forum midis të tjerash u diskutua mbi sfidat me të cilat përballen sot skemat e pensioneve në kohën e "Post-Brexit", mjetet dhe mënyrat që përdoren për menaxhimin e riskut si dhe shkëmbimi i praktikave më të mira për një mbarëvajtje sa më të suksesshme të skemave të pensioneve.

—○○○—
Tema kryesore e këtij forumi ishte “Asetet afatgjata të fondeve të pensioneve, pavarësia dhe investitorët në sigurime në kohën e riorganizimit ekonomik dhe ndryshimeve rregullatore”.

Ndër temat e trajtuara në seksionet e ndryshme ishin edhe:

- Investimet afatgjata dhe menaxhimi i riskut në një mjedis me norma të ulta interesi;
- Qeverisja dhe kujdesi mbi kapitalin;
- Qëndrueshmëria pas miratimit të marrëveshjes së Parisit COP21 (Në konferencën e Parisit, në dhjetor 2015, 195 vende adoptuan për herë të parë një marrëveshje universale, ligjërisht të detyrueshme, për klimën globale);
- Investimet dhe pensionet;
- Hartimi i sistemeve moderne të pensioneve dhe reforma e pensioneve, etj.

Lektorë të ndryshëm diskutuan edhe mbi përvojat e vendeve të tyre mbi investimet e brendshme, çështjet e lidhura me menaxhimin e aseteve, harmonizimin e të dhënave, rregullat mbi investimet ndërkufitare në letra me vlerë, etj.

Zhvillohet Seminari Ndërkombëtar për Mbikëqyrjen e Pensioneve si dhe Mbledhjet e Komitetit Teknik dhe Komitetit Ekzekutiv të IOPS-it

Në datat 22-24 shkurt 2017 në Runaway Bay, Xhamajka, u zhvillua Seminari Ndërkombëtar për Mbikëqyrjen e Pensioneve me temë “Panorama e skemave

të pensioneëve, progresi, perspektivat dhe sfidat”. Ky seminar u organizua nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneëve (*International Organisation of Pension Supervisors, IOPS*) në bashkëpunim me Organizatën për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik, (OECD) dhe Komisionin e Shërbimeve Financiare të Xhamajkës (FSC).

Gjatë seminarit u diskutua për rëndësinë e skemave të pensioneëve dhe lidhjen e tyre me sigurimin e të ardhurave në momentin e daljes në pension, për një kuadër rregullator të qëndrueshëm për të rritur efikasitetin e mbikëqyrjes në tregun e pensioneëve, si dhe për çështjet që lidhen me ndërveprimin e fondeve të pensionit me tregjet financiare.

Në vijim të seminarit u zhvilluan Mbledhjet e Komitetit Teknik dhe Ekzekutiv të IOPS si dhe *workshop*-i me temë “Mbikëqyrja me bazë rreziku”. Në mbledhjen e Komitetit Teknik dhe Komitetit Ekzekutiv të IOPS-it diskutimet kryesore u zhvilluan për parimet bazë të pensioneëve, jetëgjatësinë dhe pensionin, tregjet e kapitalit dhe instrumentet për transferimin e riskut të jetëgjatësisë, etj.

Gjatë mbledhjeve të Komiteteve të IOPS-it u diskutua për udhëzuesin mbi praktikën më të mira për qeverisjen e autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneëve. Ekspertë të IOPS-it prezantuan edhe projektet e bashkëpunimit me organizmat ndërkombëtare si Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar në fushën e pensioneëve, ecurinë e punës për rishikimin e parimeve bazë të mbikëqyrjes së pensioneëve, si dhe programi i IOPS-it për vitet 2018-2019.

Seminari u fokusua te rëndësia e skemave të pensioneëve dhe lidhjen e tyre me sigurimin e të ardhurave në momentin e daljes në pension, për një kuadër rregullator të qëndrueshëm për të rritur efikasitetin e mbikëqyrjes në tregun e pensioneëve.

AMF organizoi takim informues me median me fokus tregun e sigurimeve në Shqipëri



Drejtes të lartë të AMF-së gjatë takimit informues me median

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi në datën 15 shkurt 2017 një takim informues me gazetarë të mediave të shkruara dhe vizive që pasqyrojnë lajmet ekonomike.

Ky takim i hapur është pjesë e një iniciative më të gjerë informative dhe edukative që po ndiqet nga AMF në kuadër të rritjes së transparencës dhe njohurive financiare rreth tregjeve në mbikëqyrje. Fokusi i takimit të parë të kësaj iniciative ishte tregu i sigurimeve.

Gjatë prezantimit të saj Znj. Erda Cani, Drejtore e Departamentit të Zhvillimeve Strategjike, TI dhe Statistikës u përqendrua në informimin për rolin, strukturën dhe funksionimin e AMF-së. Një aspekt mjaft i rëndësishëm ishte informimi në lidhje me projektet e asistencës teknike të ndjekura nga AMF, bashkëpunimin institucional në rang kombëtar dhe ndërkombëtar duke informuar gazetarët që AMF është tashmë pjesëmarrëse e kolegjeve mbikëqyrëse të grupeve të sigurimit që kanë aktivitet në vend. Gjithashtu, gazetarët u njohën edhe me rregulloren “Për komunikimin me median dhe publikun, publikimet dhe funksionimin e faqes së Internetit”.

Z. Artur Ribaj, Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes Financiare bëri një prezantim të detajuar të ecurisë dhe treguesve statistikorë të tregut të sigurimeve në Shqipëri. Z. Ribaj theksoi se AMF ka filluar zbatimin e metodologjisë së mbikëqyrjes me bazë rreziku dhe shpjegoi rolin e kësaj metodologjie për një mbikëqyrje efektive.

Në prezantimet e tyre, gazetarët u informuan edhe për iniciativat në hartimin dhe rishikimin e legjislacionit lidhur me tregun e sigurimeve në vend, me përgatitjen e ndryshimeve të reja ligjore për sigurimet e detyrueshme. Gjithashtu, u theksua fakti që synimi i AMF-së është zbatimi i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi, me qëllim ruajtjen e shëndetit financiar të shoqërive në tregjet në mbikëqyrje, për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm të tyre në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve.

Gjatë seancës informuese u theksua se marrëdhënia e konsumatorit me shoqëritë e sigurimit është një marrëdhënie afatgjatë, e cila nuk duhet kufizuar vetëm tek sigurimet e detyrueshme, por duhet që vëmendja e qytetarëve të kthehet edhe drejt sigurimeve vullnetare dhe në këtë drejtim mediat kanë një rol mjaft të rëndësishëm.

Në përfundim të prezantimeve, gazetarët drejtuan edhe disa pyetje konkrete, që lidheshin me çështje si ecuria e çmimeve të sigurimit të detyrueshëm motorik dhe hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore.

Zhvillohet Forumi Ndërkombëtar mbi Sigurimet dhe Konferenca Evropiane për Mbrojtjen Konsumatore

Më 15 shkurt 2017 u zhvillua në Vjenë Forumi i 3-të Ndërkombëtar i Sigurimeve me temë “Sfidat e reja për industrinë e sigurimeve motorike”. Forumi trajtoi tema të rëndësishme që lidhen me sigurimin motorik në vendet e Evropës

Gazetarët u informuan edhe për iniciativat në hartimin dhe rishikimin e legjislacionit lidhur me tregun e sigurimeve në vend, me përgatitjen e ndryshimeve të reja ligjore për sigurimet e detyrueshme.

Qendrore dhe Lindore, i cili vazhdon të jetë linja më sfiduese e biznesit. Forumi vlerësoi efektet e faktorëve që kanë ndikim mbi biznesin e sigurimeve motorike, mundësitë dhe sfidat e së ardhmes për industrinë e sigurimeve.

Temat kryesore të diskutimeve në këtë forum ishin:

- Çmimet, shitja dhe ofrimi i shërbimeve në tregun e sigurimit motorik;
- Mbikëqyrja e produkteve dhe rregullat e qeverisjes;
- Mjetet kryesore për mbrojtjen konsumatore;
- Problematikat e lidhura me sistemin e Solvency 2, etj.

Në Forum u evidentuan praktikat më të mira në mbikëqyrjen e produkteve të sigurimeve motorike. Rregullat e qeverisjes si dhe të ndërmjetësimit duhet të synojnë parandalimin dhe zbutjen e dëmtimit të konsumatorit, menaxhimin e konfliktit të interesit duke siguruar mbrojtjen e konsumatorëve.

Për sigurimin motorik, mbikëqyrja e produktit dhe rregullat e qeverisjes lidhen me disa faza që fillojnë që me vendosjen e çmimit dhe mbulimin me produkt të të gjithë tregut, procesin e shitjes dhe informimin e konsumatorit si edhe fazën e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim. Në Forum u diskutua me shembuj konkretë lidhur me parametrat e çmimeve të sigurimit motorik në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, sistemi i Kartonit Jeshil dhe dixhitalizimi i sistemit të sigurimeve motorike në këto vende.

Me 16 shkurt u zhvillua Konferenca Evropiane për Mbrojtjen Konsumatore e cila trajtoi tema që lidhen me aktet rregullatore në shërbimet financiare, tendencat kryesore për mbrojtjen konsumatore në kuadër të BE-së. Në konferencë u theksua rëndësia e ndërtimit të një kuadri rregullator të kujdesshëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar një risk sa më të ulët nga ana e siguresit për të përmbushur detyrimet ndaj konsumatorit. Në diskutime u theksua se kuadri rregullator për stabilitetin financiar siguron tregun që të veprojë në mënyrë efikase për të minimizuar riskun sistematik.

Në konferencë u diskutua edhe nevoja e balancimit midis mbrojtjes konsumatore dhe përgjegjësive të konsumatorit në sigurime. Lidhur me këtë u diskutua mbi rolin e informacionit dhe edukimit financiar si çelësi i përgjegjësisë së konsumatorit.

Përfaqësuesi i EIOPA-s (Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale) theksoi rëndësinë që kjo organizatë i kushton mbrojtjes së konsumatorit e cila do të vazhdojë të jetë një nga prioritetet strategjike. Duke e lidhur mbrojtjen e konsumatorit me mbikëqyrjen e sjelljes së biznesit,

○○○
Konferenca Evropiane
për Mbrojtjen
Konsumatore trajtoi
tema që lidhen me
aktet rregullatore,
shërbimet financiare,
tendencat kryesore për
mbrojtjen konsumatore
në kuadër të BE-së.
○○○

përfaqësuesi e EIOPA-s theksoi se vendet anëtare të Bashkimit Evropian janë në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre sa i përket qasjes për mbrojtjen e konsumatorit. EIOPA ka zhvilluar një strategji për të forcuar zhvillimin e biznesit.

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare takohet me përfaqësues të Bankës Qendrore Evropiane

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi, priti në datën 9 shkurt 2017 përfaqësues të Bankës Qendrore Evropiane.

Gjatë këtij takimi, Znj. Shehi, bëri një prezantim të ecurisë së tregjeve nën mbikëqyrje të AMF-së dhe zhvillimeve kryesore në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ. Përfaqësuesit e Bankës Qendrore Evropiane u njohën me rolin e AMF-së në kuadër të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, punën e bërë në evidentimin e risqeve të sistemit financiar, si dhe iniciativat e reja në tregun e kapitalit.

Znj. Shehi, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe organizatat ndërkombëtare në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të tregjeve financiare dhe forcimit të kapaciteteve mbikëqyrëse.

AMF fillon fazën e dytë të projektit për zhvillimin dhe forcimin e tregut të kapitaleve

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare filloi zbatimin e fazës së dytë të projektit “Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare: Fokusi tek zhvillimi i tregut të kapitaleve”. Ky projekt financohet nga Sekretariati i Shtetit Zvicëran për Çështjet Ekonomike (SECO) dhe mbështetet nga Banka Botërore.

Faza e dytë e projektit, e cila ka filluar në 30 janar 2017, fokusohet në shqyrtimin dhe zhvillimin e legjislacionit dhe kuadrit mbikëqyrës për tregun e fondeve të investimeve dhe letrave me vlerë.

Kjo fazë e projektit synon:

- Hartimin dhe zhvillimin e metodologjisë së mbikëqyrjes së tregut të fondeve të investimeve, duke përfshirë edhe përgatitjen e manualeve dhe mjeteve të tjera të nevojshme për mbikëqyrje;

—○○○—
Përfaqësuesit e Bankës Qendrore Evropiane u njohën me rolin e AMF-së në kuadër të Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar, punën e bërë në evidentimin e risqeve të sistemit financiar, si dhe iniciativat e reja në tregun e kapitalit.
—○○○—

- Përgatitjen e amendimeve apo akteve të tjera ligjore që do të shoqërojnë metodologjinë e re mbikëqyrëse;
- Përmirësimin e aftësisë për menaxhimin e skenarëve të krizave;
- Rishikimin e kuadrit rregullator dhe mbikëqyrës për emetimin e obligacioneve të shoqërive dhe qeverive lokale, si edhe rekomandimin e ndryshimeve të nevojshme.

Gjatë muajit shkurt 2017, ekspertët e Cadogan Financial, kompanisë fituese për realizimin e kësaj faze të projektit, kryen takime me stafin e AMF-së, përfaqësues të tregut si dhe palët e interesuara si Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

Kjo fazë e projektit do të zgjasë rreth 20 muaj dhe Autoriteti do të mbështetet në vazhdimësi nga ekipi i ekspertëve të huaj.

Trajnimi mbi parimet, praktikat dhe bazat e mbikëqyrjes në sigurime me fokus rrezikun, në funksion të rritjes së kapaciteteve profesionale të stafit të AMF-së

Gjatë trajnimit u diskutua lidhur me parimet, praktikat dhe politikat në sigurime. Tematikat e trajtuara lidheshin si me koncepte teorike ashtu edhe me praktikat specifike të punës gjatë mbikëqyrjes në sigurime.



Gjatë trajnimit mbi parimet e praktikat dhe bazat e mbikëqyrjes në sigurime

Qendra e Edukimit e AMF-së organizoi një trajnim dy javor në datat 23 janar – 3 shkurt 2017 për punonjësit e Autoritetit me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale të tyre. Pjesëmarrës në trajnim ishin specialistë dhe ekspertë të departamentit të mbikëqyrjes së sigurimeve, si edhe punonjës nga drejtori të tjera AMF-së.

Gjatë trajnimit u diskutua lidhur me parimet, praktikat dhe politikat në sigurime. Tematikat e trajtuara lidheshin si me koncepte teorike ashtu edhe me praktikat specifike të punës gjatë mbikëqyrjes në sigurime.

Temat më kryesore ishin:

- Parimet themelore në sigurime dhe mbikëqyrja me bazë rreziku;
- Kategoritë bazë të menaxhimit të rrezikut;
- Principet kryesore të menaxhimit të riskut dhe synimet, objektivat dhe përfitimet e tij;
- Procesi i marrjes në sigurime, lidhja dhe analizimi i kontratave;
- Procesi i trajtimit të dëmeve;
- Menaxhimi personal i rreziqeve;
- Etika në sigurime;
- Bazat e mbikëqyrjes së sigurimeve me fokus rrezikun.

Gjatë trajnimit mjaft nga çështjet u shoqëruan edhe me prezantimin e rasteve studimore.

Trajnimi për punonjësit e AMF-së u drejtua nga Z. William Cundif, trajner i huaj, ekspert i pavarur me eksperiencë shumëvjeçare në fushën e sigurimeve.

Qendra e Edukimit pranë AMF-së prezanton programin e punës për vitin 2017

Qendra e Edukimit, e krijuar si pjesë e strukturës organizative të AMF-së, edhe gjatë vitit 2017 do të vazhdojë programin e trajnimeve për formim profesional dhe edukim në vazhdimësi duke kontribuar në rritjen e kapaciteteve profesionale të drejtuesve dhe profesionistëve që operojnë në tregun e sigurimeve. Këto trajnime synojnë zhvillimin e mëtejshëm të tregut të sigurimeve dhe ofrimin e produkte dhe shërbime të cilësisë së lartë për konsumatorët.

Disa nga trajnimet që do të organizohen gjatë vitit 2017 janë:

- Trajnim për kualifikim profesional për aktuar. Gjatë vitit 2017 do të kryhen edhe modulet e fundit të këtij trajnimi afatgjatë dhe do të jepen edhe diplomat përfundimtare për këto profesionistë të rinj;
- Trajnim për punonjësit e AMF-së lidhur me mbikëqyrjen në sigurime, mbikëqyrjen me fokus rreziku, mbi standardet ndërkombëtare të kontabilitetit, etj;
- Trajnim për kualifikim profesional dhe për edukimin në vazhdimësi për broker në sigurime;
- Trajnimi për kualifikim profesional dhe për edukimin në vazhdimësi për vlerësues dëmsh në sigurime.

AMF ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Institutin dhe Fakultetin e Aktuarëve në Londër dhe Shoqatën Shqiptare të Aktuarëve. AMF gjithashtu ka krijuar një grup të gjerë trajnerësh me eksperiencë disa vjeçare në mbikëqyrjen dhe rregullimin e tregjeve të sigurimeve në vende mjaft të zhvilluara. Ky grup

AMF ka lidhur
marrëveshje
bashkëpunimi me
Institutin dhe Fakultetin
e Aktuarëve në Londër
dhe Shoqatën
Shqiptare të Aktuarëve.

trajnerësh bashkëpunon me Autoritetin në hartimin e programeve të kualifikimit dhe dhënien e leksioneve për profesionistët dhe stafin e AMF-së.

Programi i detajuar i trajnimeve që do të organizohen nga kjo qendër është i vendosur në faqen online të AMF-së <http://amf.gov.al/qendra.asp?p=1&p1=4&p2=&p3=>

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare takohet me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi, priti në datën 19 janar 2017 përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), në kuadrin e misionit të tyre të radhës. Misioni i FMN-së u përfaqësua në këtë takim nga Z. Jens Reinke, përfaqësuesi rezident i misionit të FMN-së në Shqipëri dhe Z. Ezequiel Cabezon, Departamenti për Evropën.

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, Znj. Shehi, bëri një prezantim të zhvillimeve të fundit, si dhe të progresit të arritur në mbikëqyrjen e tregjeve financiare, përmes strategjisë së rritjes së kapaciteteve mbikëqyrëse, përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullator, inspektimeve të plota dhe tematike, duke ju përgjigjur zhvillimeve të tregut financiar me mbikëqyrje efektive me Fokus Rrezikun.

Krijimi i një kuadri ligjor dhe rregullator për menaxhimin e krizave financiare, mundësitë e zhvillimit të tregjeve dhe arritja e mbikëqyrjes së konsoliduar në bashkëpunim me autoritete të tjera rregullatore brenda dhe jashtë Shqipërisë, ishin ndër çështjet e tjera që u diskutuan në këtë takim.

IOSCO diskuton mbi teknologjinë financiare në tregun e letrave me vlerë

IOSCO organizoi më 27 janar 2017 mbledhjen e Komitetit Rajonal Evropian (*IOSCO European Regional Committee Meeting, ERC Meeting*) në Paris, Francë. Fokusi i takimit ishte kryesisht në mundësinë e ndryshimeve që sjell teknologjia financiare, e njohur si FinTech.

Në një raport të publikuar nga IOSCO theksohet rëndësia e ndërlidhjes midis teknologjisë financiare, FinTech me tregun e letrave me vlerë dhe përshkruhet ndikimi që ajo ka mbi investitorët dhe shërbimet financiare. Raporti i kërkimor i IOSCO-s për teknologjitë financiare përshkruan një shumëllojshmëri të modeleve të reja të biznesit dhe teknologjive të reja të cilat kanë transformuar

Drejtorja e
Përgjithshme
Ekzekutive e AMF-së,
Znj. Shehi, bëri një
prezantim të
zhvillimeve të fundit, si
dhe të progresit të
arritur në mbikëqyrjen e
tregjeve financiare.

industrinë e shërbimeve financiare, duke përfshirë edhe:

- Platformat e financimit (*Financing Platforms: peer-to-peer lending and equity crowdfunding*);
- Tregtimi i investimeve tek blerësit individë përmes platformave online, duke përfshirë këshilltarë robot dhe tregtimin përmes rrjeteve sociale;
- Platformat e tregimit të investimeve tek blerësit institucionalë, me një fokus të veçantë në tregtimin e obligacioneve;
- Përhapja e monedhave dixhitale, (*distributed ledger technologies*) duke përfshirë edhe aplikimin e teknologjisë së *blockchain* dhe monedhave të tjera dixhitale në tregjet e letrave me vlerë.

Raporti analizon si mundësitë ashtu edhe rreziqet që sjell përdorimi i këtyre teknologjive të reja për investitorët në tregun e letrave me vlerë dhe mbikëqyrësit e tyre.

○○○

Raporti analizon si mundësitë ashtu edhe rreziqet që sjell përdorimi i këtyre teknologjive të reja për investitorët në tregun e letrave me vlerë dhe mbikëqyrësit e tyre.

○○○

Mbikëqyrës të ndryshëm në mbarë botën po merren me çështjet e lidhura me FinTech. Në tregun e letrave me vlerë, ndërsa teknologjitë e reja zbatohen në nivelin global, rregullimi i këtyre teknologjive të reja kryhet kryesisht brenda kufijve kombëtarë. Natyra lokale e rregullimit mund të krijojë sfida në lidhje me mbikëqyrjen ndërkufitare dhe zbatimin e mbikëqyrjes efektive, ndërsa mospërputhjet rregullatore në juridiksione të ndryshme rrisin mundësinë për arbitrazh rregullator.

Raporti i plotë mund të gjendet në faqen zyrtare të IOSCO-s <http://www.iosco.org/library/pubdocs/pdf/IOSCOPD554.pdf>

Eksplorimi i Horizonteve të Reja

Fjala e Z. Gabriel Bernardino, Kryetar i Autoritetit Evropian të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (European Insurance and Occupational Pensions Authority, EIOPA) mbajtur në Konferencën e 6-të Vjetore në Frankfurt, 18 tetor 2016.

Duke reflektuar vizionin dhe strategjinë e re të EIOPA-s tematika e konferencës u fokusua në "Eksplorimin e horizonteve të reja" nëpërmjet tre paneleve. Tematikat kryesore të fjalës së mbajtur nga Z. Bernardino lidheshin me katër çështje: (i) metoda gjithëpërfshirëse e EIOPA-s për konvergencën në mbikëqyrje (supervisory convergence); (ii) zhvillimi i produkteve personale të pensionit në Evropë (Pan-European Personal Pension Product, PEPP) në kuadrin e Bashkimit të Tregjeve të Kapitalit; (iii) prioritetet e axhendës së EIOPA-s për mbrojtjen e konsumatorit e lidhur me zbatimin e direktivës Insurance Distribution Directive (IDD) në procesin e dixhitalizimit; (iv) hapat e mëtejshëm në kuadrin rregullator dhe sfidat në vazhdim.

Pjesa e tretë (marrë me shkurtime)

<https://eiopa.europa.eu/Publications/Speeches%20and%20presentations/2016-10-18%20EIOPA%20Annual%20Conference.pdf>

Tema e tretë lidhet me prioritetet e vendosura në axhendën e EIOPA-s për mbrojtjen e konsumatorit nga zbatimi i Direktivës së Shpërndarjes në Sigurimeve (Insurance Distribution Directive, IDD) për dixhitalizimin.

—○○○—
EIOPA e ka vendosur mbrojtjen e konsumatorit në qendër të strategjisë së saj, si nëpërmjet kuadrit rregullator ashtu edhe sjelljes së kujdesshme në biznes.

EIOPA e ka vendosur mbrojtjen e konsumatorit në qendër të strategjisë së saj, si nëpërmjet kuadrit rregullator ashtu edhe sjelljes së kujdesshme në biznes. Sjelljet e gabuara të firmave jo vetëm mund të dëmtojnë konsumatorët individualë, por mund të kenë edhe një ndikim më të gjerë, duke paraqitur një kërcënim për stabilitetin e sektorit financiar.

Në këtë kontekst, zbatimi i Direktivës së Shpërndarjes në Sigurimeve, IDD, është një hap i rëndësishëm përpara. EIOPA e ka konsultuar këtë draft me Komisionin Evropian mbi aktet e mundshme në çështje të tilla si mbikëqyrja e produktit dhe qeverisja, konflikti i interesave, nxitja dhe vlerësimi i përshtatshmërisë dhe përputhjes.

Synimi ynë është të sigurohemi që interesat e konsumatorëve janë marrë në konsideratë gjatë gjithë ciklit të jetës së një produkti, që aktivitetet e shpërndarjes janë kryer në përputhje me interesin më të mirë të konsumatorëve dhe që konsumatorët blejnë produkte/polica të sigurimit të cilat janë të përshtatshme për ta.

Një tjetër projekt i rëndësishëm për EIOPA në kuadër të Direktivës së Shpërndarjes në Sigurimeve është edhe Dokumenti mbi Informacionin e Produktit të Sigurimit (Insurance Product Information Document, IPID). Qëllimi

i tij është të sigurojë që klienti e ka informacionin e duhur në lidhje me një produkt të sigurimit të Jo-Jetës dhe që ky informacion e lejon atë të krahasojë mes ofertave të ndryshme për produkte të sigurimeve duke e mundësuar kështu të marrë vendime të mirinformuara nëse do ta blejë apo jo një produkt. EIOPA ka zhvilluar një model për IPID i cili do të vazhdojë të konsultohet me publikun.

Shoqëria sot po përballet me risi teknologjike të njëpasnjëshme dhe rritjen e vazhdueshme të përdorimit e të dhënave të mëdha. Ky revolucion dixhital po e transformon tërësisht mënyrën se si ne ndërveprojmë dhe bëjmë biznes. Edhe tregu i sigurimeve po përballet tashmë me këtë realitet.

Diskutime dhe opinionet e ndryshme janë se tregu gjithmonë është përballur me ndryshime dhe se ky i tanishmi është vetëm një tjetër etapë e përballjes me ndryshimin. Kjo është e vërtetë, por ky ndryshim, i cili vjen nga epoka dixhitale është i ndryshëm: në shumë aspekte ai nuk është një rritje; por është i shoqëruar me shqetësime.

I gjithë zinxhiri i vlerave në tregun e sigurimeve do të ndikohet nga këto ndryshime, si siguruesit e mëdhenj, ndërmjetësit, shpërndarësit dhe ofruesit e shërbimeve. Ne do të shohim disa modele të biznesit të deritanishëm që do të jenë të kërcënuar, ndërkohë që të tjera biznese do të zbatojnë modele të biznesit që do të reduktojnë në mënyrë dramatike kostot tradicionale. Përdorimi i të dhënave të mëdha dhe telematike, mundësitë e krahasimit të faqeve të Internetit si edhe mundësitë e marrjes në mënyrë automatike të këshillave do të ndikojnë në komunikimin me konsumatorët. Sasia e rritur e të dhënave personale në dispozicion dhe fuqia e analizimit të të dhënave, do të ndryshojë në mënyrë të pashmangshme modelet e marrjes në sigurim.

Siç e dimë, ndryshimet sjellin rreziqe, por ofrojnë njëkohësisht edhe mundësi të tjera.

Në këndvështrimin pozitiv, ky ndryshim ka potencialin për të prodhuar rezultate më të mira për konsumatorët, nëpërmjet zhvillimit të shërbimeve dhe produkteve më të personalizuar, sikurse edhe të menaxhimit më të mirë të rreziqeve apo situatave të mashtrimit. Por gjithashtu ngre disa çështje lidhur me aksesin në shërbimet financiare për konsumatorë të caktuar, transparencën në lidhje me përdorimin e të dhënave personale dhe rreziqet e lidhura me sigurinë kibernetike.

Duke filluar nga viti 2017, EIOPA do të organizojë një seri tryezash të rrumbullakëta të lidhura me zhvillimet teknologjike dhe sigurimet "Insurtech". Objektivi do të jetë të mësojmë nga aktorë të ndryshëm për zhvillimet në këtë fushë, të mirat dhe rreziqet për konsumatorët dhe pengesat e mundshme për praktikën e mira të inovacionit. Në përfundim, kjo do t'i shërbejë zhvillimit të një kuadri rregullator që nxit standardet më të larta të mbrojtjes së konsumatorit, ndërkohë që nuk i pengon inovacionet teknologjike.

Shoqëria sot po përballet me risi teknologjike të njëpasnjëshme dhe rritjen e vazhdueshme të përdorimit e të dhënave të mëdha. Ky revolucion dixhital po e transformon tërësisht mënyrën se si ne ndërveprojmë dhe bëjmë biznes.

Çeki

www.xprimm.com

Sipas Shoqatës së Sigurimeve Çeke (*Czech Insurance Association, CAP*), në fund të vitit 2016, vlera e përgjithshme e primeve të shkruara bruto në tregun çek të sigurimeve arriti, në rreth 4.4 miliardë euro e cila paraqet një rritje prej 2.1% krahasuar me vitin e kaluar.

Tregu i sigurimit të Jetës ka treguar një dinamikë negative, me një rënie prej 1.8% krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në 1.6 miliardë euro, ndërsa tregu i sigurimit të Jo-Jetës u rrit me 4.5 duke arritur në 2.8 miliardë euro.

Në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës, sigurimet motorike MTPL dhe sigurimi Kasko kishin edhe pjesën më të madhe të primeve të shkruara bruto.

Kosovë

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, BQK, tregu i sigurimeve të Jo-Jetës në Kosovë arriti vlerën e 81.2 milionë euro të primeve të shkruara bruto, ose 3.1% më shumë krahasuar me vitin e kaluar. Në të njëjtën kohë, volumi i dëmeve të paguara nga siguruesit lokalë mbeti thujt në të njëjtin nivel me atë të vitit 2015, rreth 39 milionë euro.

Në volumin total të primeve të shkruara bruto, sigurimet e detyrueshme TPL zinin rreth 56%, policat kufitare zinin 8.5% dhe pjesën tjetër e zinin klasat e tjera të Jo-Jetës.

Dinamika pozitive e tregut të sigurimeve u mbështet nga rritja e dyshifrore e raportuar në sigurimet vullnetare në klasat e Jo-Jetës (me rritje 13% duke arritur në 28.8 milionë euro) si dhe nga rritja 5.5% në klasat e përgjegjësive ndaj palëve të treta, TPL (për 45.5 milionë euro).

Nga ana tjetër, volumi i primeve nga policat kufitare ra me një të tretën, krahasuar me vitin e kaluar, duke arritur në 6.9 milionë euro.

Mali i Zi

www.xprimm.com

Tregu i sigurimeve i Malit të Zi pati një rritje prej 4.2% të volumit të primeve të shkruara bruto në vitin 2016. Sipas të dhënëve paraprake të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi (*Insurance Supervision Agency of Montenegro, ISO*) volumi i primeve arriti në 80.1 milionë euro. Sigurimi i Jo-Jetës kishte pjesën më të madhe me rreth 83% të totalit të primeve të shkruara bruto, ndërsa sigurimi i Jetës kishte 17%. Krahasuar me shifrat e vitit 2015, tregu i sigurimeve u rrit me 3.2 milionë euro.

Kontributi më i madh në rritjen e volumit të primeve i takon primeve nga sigurimet MTPL, me një rritje prej 2.3 milionë euro, ndërsa sigurimi i Jetës u rrit me 0.8 milionë euro.

Në fund të vitit 2016, tre siguruesit më të mëdhenj sipas volumit të primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jetës ishin siguruesit austriake, GRAWE, Wiener STAEDITCSHE dhe MERKUR të cilët zinin rreth 75%. Ndërsa në sigurimin e Jo-Jetës, tregu është dominuar nga dy siguruesit slovene - Lovcen Osiguranje dhe SAVA Malit të Zi, me rreth 63% të totalit të volumit të primeve të shkruara të Jo-Jetës.

Turqi

www.xprimm.com

Sipas të dhënëve paraprake të publikuara nga Shoqata e Sigurimeve të Turqisë (*Insurance Association of Turkey – TSB*) volumi total i primeve të shkruara bruto në tregun e sigurimeve në vend tejkaloi vlerën e 40 miliardë TRY (Lira Turke) ose rreth 11 miliardë euro gjatë vitit 2016 duke shënuar kështu një rritje prej më shumë se 30% në krahasim me vitin e kaluar. Shifrat e publikuara tregojnë se sektori i sigurimeve i Turqisë u rrit me 20.2% në terma reale gjatë vitit të kaluar, rritje kjo e korrigjuar nga norma vjetore e inflacionit, e cila ishte 8.5%.

Tregu i sigurimeve të Jo-Jetës, gjatë vitit 2016, zuri 87.6% të totalit të tregut, ndërsa tregu i sigurimeve të Jetës, kishte rreth 12.4% të totalit.

Megjithatë, duke krahasuar normat e rritjes për të dy tregjet, tregu i sigurimeve të Jetës u rrit me 34%, ndërsa ai i sigurimeve të Jo-Jetës u rrit me 30%.

Ndër kompanitë që gjeneruan volumin më të madh të primeve të shkruara bruto ishte ALLIANZ Sigorta me rreth 14.3% e ndjekur nga Anadolu Sigorta me rreth 11.1% dhe AXA Sigorta me 8.8% të tregut të sigurimeve gjatë vitit 2016.

amf ALBANIA

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al